

Njoftim i përqendrimit me të cilin Certis Belhim B.V. (Certis Belchim B.V.), Holandë dhe Redestos S.A. (Redestos S.A.), Greqi, formojnë një sipërmarrje të përbashkët me funksione të plota

(lënda nr. 08-111/2024)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 29.07. 2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin Certis Belhim B.V. me seli të regjistruar në Shtadsplatau 16, Kutia Postare 607, 3500 AP Utreht, Holandë, ("Certis Belhim"), e cila është nën kontrollin përfundimtarë të Mitsui & Co., Ltd. (Mitsui & Co., Ltd.; së bashku me shoqëritë e saj të varura të shënuara si "Grupi Matsui ") dhe Redestos S.A. me seli të regjistruar në Zonën Industriale të Selanikut, Kutia Postare 48, 570 22 Sindos, Greqi, (Redestos"; së bashku me shoqëritë e saj të varura në tekstin e mëposhtëm të shënuara si "Grupi Redestos "), formojnë një sipërmarrje të përbashkët me funksione të plota.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit

Grupi Mitsui është një nga konglomerat më të mëdhenj të korporatave (i ashtuquajtur keiretsu) në Japoni. Grupi Mitsui përfshin një numër shoqëri, shumica e të cilave janë korporata të mëdha ndërkombëtare si Mitsui & Co. (Mitsui & Co.); Mitsui Hemikals (Mitsui Chemicals); Mitsui Konstrakshn Ko. (Mitsui Construction Co.) Mitsui Inyhinering end Shipbuilding Ko. (Mitsui Engineering and Shipbuilding Co.), Mitsui Majning & Smelting Ko. (Mitsui Mining & Smelting Co.) etj.

Mitsui & Co. (Mitsui & Co.) është shoqëria themelore në Grupin Mitsui dhe një nga shoqëritë më të mëdha tregtare në Japoni për tregti të përgjithshme.

Shoqëria kryesisht funksionon si një shoqëri holding e disa shoqërive të varura dhe të lidhura, e cila menaxhon porositë dhe organizon shpërndarjen e mallrave dhe mallrave industriale, bujqësore dhe të konsumit.

Në përgjithësi, Grupi Mitsui ka shtatë segmentet e mëposhtme operative:

burimet minerale dhe metalike, energjia, inxhinieria mekanike dhe infrastruktura, kimikatet, produktet e hekurit dhe çelikut, mënyra e jetesës dhe inovacioni dhe zhvillimi i korporatës.

Certis Belhim është një shoqëri globale me seli në Utreht, Holandë, e kontrolluar në mënyrë të pavarur nga Grupi Mitsui. Certis Belhim është aktive në sektorin e mbrojtjes së bimëve me fokus në bujqësinë e qëndrueshme, mbrojtjen e bimëve, zhvillimin e produkteve, regjistrimin dhe marketingun brenda industrisë bujqësore. Shoqëria ka një prezencë të drejtpërdrejtë, nëpërmjet shoqërive të saj të varura, pothuajse në të gjitha vendet e Evropës, SHBA-së dhe Kanadasë dhe bën shitje nëpërmjet partnerëve të saj lokalë në Azi, Amerikën e Jugut, Afrikë dhe Australi.

Grupi Redestos është aktiv në sektorin e bujqësisë në Greqi, Evropën Juglindore dhe Lindjen e Mesme. Aktivitetet e Grupit Redestos përfshijnë këto njësi biznesi: mbrojtjen dhe kultivimin e bimëve, materialet e shumimit të bimëve, shërbimet laboratorike dhe konsulente, si dhe prodhimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore.

Redestos është aktiv në zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve për mbrojtjen e bimëve, plehrave të specializuara dhe farërave.

Në Maqedoninë e Veriut, Parashtruesit janë aktivë ose nëpërmjet shpërndarësve lokalë të palëve të treta ose përmes shitjeve direkte të eksportit dhe përmes KNE Certis dhe kompanisë së saj të varur

lokale, KNE CERTIS SHPKNJP Gjevgjeli, me seli të regjistruar në bulevardin e Gjevgjelisë nr. 16, Gjevgjeli, veprimtaria e biznesit të së cilës është shitja e produkteve për mbrojtjen e bimëve, plehrave të specializuara dhe farërave te tregtarët me shumicë (46,75 – tregtia me shumicë e produkteve kimike).

Sipas parashtruesve të njoftimit, tregu relevant i mallrave për përqendrimin në fjalë mund të përkufizohet si treg për shitjen e produkteve për mbrojtjen e bimëve, plehrave të specializuara dhe farërave.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

12.08.2024

Shkup